



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:283757

Datë: 15.11.2024

Numri i dokumentit: 06495785

2024:283758

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurës V.T. nga Ferizaj, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit me ND.nr.137/2024, të datës 30.10.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurës në njërën anë dhe të dëmtuarës E.M., në anën tjetër, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1627/24, të datës 10.10.2024, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, në mbështetje të nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datën 15.11.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja ND.nr.137/2024, të datës 30.10.2024, e lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj në mes të pandehurës V. J. T., e lindur me dt..... në Ferizaj, ku dhe tani jeton në rr. “....”, me nr. personal në njërën anë dhe të dëmtuarës E. A. M., nga Shtimja, rruga “.....” pa nr, në anën tjetër.

Hudhet aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1627/24, të datës 10.10.2024 dhe PUSHON procedura penale kundër pandehurës V.T., për vepër penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1627/24, të datës 10.10.2024, të pandehurën e ka akuzuar, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, dhe kërkuar që e pandehura të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Me dakordimin e palëve në shqyrtimin fillestar me dt.30.10.2024, konform nenit 4 dhe 8 të Ligjit për ndërmjetësim, u vendos që lënda të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim.

Me datën 30.10.2024 në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja ND.nr.137/2024 në mes palëve në procedurë.

Andaj Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim e aprovoj këtë marrëveshje pasi që e njëjta u vlerësua se është lidhë me vullnetin e plotë të palëve për çështjen dhe është në pajtim me ligjin për ndërmjetësim në fuqi.

Konform nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim më datën 15.11.2024, aprovohet nga gjykata marrëveshja për ndërmjetësim dhe e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Konform nenit 454 par.1 të KPK-së shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 253 par. 1 pika 1.3 të KPPK lidhur me nenin 15 par.1 të ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2024:283758, me dt.15.11.2024.

Zyrtare ligjore
Kimete Bytyqi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.